



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:079374

Datë: 26.11.2024

Numri i dokumentit: 06507888

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.290/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Leon Përlaska, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të pandehurit V. A. për shkak të veprës penale “Vetëgjyqësia” nga neni 410 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.508/2022 të datës 19.04.2022, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datat 13.12.2023, 22.07.2024 dhe seanca e fundit me datë 13.11.2024, e mbajtur në prezencë të prokurorit të shtetit Arlinda Nallbani Gacaferi, të pandehurit V. A., mbrojtësit të tij av. Blerim Ademaj sipas autorizimit dhe të dëmtuarit I. A. , me datë shpalli 15.11.2024 ndërsa me datë 25.11.2024 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

V. A., i lindur me dt....., në fsh.R., Komuna Pejë, ku dhe ka vendbanim të përhershëm rr. “D. e G.” si dhe me vendbanim tjetër në V., rr.”A. I.” p.nr., i atësisë S. dhe amësisë H., e vajzërisë M., me profesion ndërtimtar, i divorcuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me dt. 14.03.2022, rreth orës 12:06 minuta, në fsh. R. Komuna e Pejës, me dashje ushtron në mënyrë arbitrare të drejtën që mendon se i takon në vend që ti drejtohet organit kompetent, në atë mënyrë që i pandehuri duke pretenduar se i takon e drejta pronësore mbi kioskën e vëllait të tij, të dëmtuarit I. A. , ditën kritike i njëjti fillimisht nga numri i tij i telefonit 045/...-... e thërret në telefon qiramarrësin A. dhe i drejtohet me fjalët “mo në atë kiosk nuk du me të pa” e më pas shkon në vendin e sipërshënuar, ashtu që i vendos drynin trafikes së vëllait të tij, i cili për një veprim të tillë njoftohet nga qiramarrësi në fjalë, i cili kioskën e kishte marr me qira nga i dëmtuari në fjalë dhe po e shfrytëzonte tash e 4 vite, ashtu që ky i fundit më pas lajmëron rastin në polici,

- me çka ka kryer veprë penale “Vetëgjyqësia” nga neni 410 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit V. A. i shqipton :

- I. DENIM ME GJOBË ne lartësi prej 1,000 (njëmijë) euro, të cilin detyrohet ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast qe i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20) euro gjobë.
- II. Obligohet i dëmtuari qe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 (njëqind) euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.
- III. I dëmtuari I. A. udhëzohet qe kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest të rregullt civil.

ARSYETIM

A. Historiku i çështjes;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm pranë kësaj gjykate me datë 19.04.2022, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.508/2022 kundër të pandehurit V. A. për shkak të veprës penale “Vetëgjyqësia” nga neni 410 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074).

Gjykata e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 13.12.2023, 22.07.2024 dhe seanca e fundit me datë 13.11.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Arlinda Nallbani Gacaferi, të pandehurit V.A., mbrojtësit të tij av. Blerim Ademaj, sipas autorizimit, të dëmtuarit I. A. dhe dëshmitarit A. H..

Gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata i administroj provat e propozuara nga prokurori i shtetit, qe përfshin dëgjimin e dëshmitarëve dhe administrimin e provave materiale, si dhe prova të propozuara nga i pandehuri, në bazë të të cilave prova gjykata e nxori përfundimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në arsyet si në vijim.

I pandehuri V. A. është shpallur fajtor për shkak se më veprimet e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e ka kryer veprën penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par.1 të KPRK-së.

Vepra penale e lartpërmendur ka këtë përshkrim ligjor:

1. Kushdo që ushtron në mënyrë arbitrare të drejtën që mendon se i takon në vend se t’i drejtohet organit kompetent, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

Vepra penale e vetëgjyqësisë hynë në kuadër të veprave penale kundër rendit publik me të cilën inkriminohet realizimi arbitrar i të drejtave nga ana e qytetarëve. Në rast se qytetarët vetë, jashtë organeve kompetente, realizojnë të drejtat e tyre do të krijohej një gjendje kaotike, prandaj sigurohet mbrojtja penalo-juridike për funksionimin e drejtë të rendit juridik. Pra, esenca e kësaj vepre penale është realizimi arbitrar i ndonjë të drejte, e cila i takon kryesit, ose konsideron që i takon atij, duke anashkaluar organet shtetërore.

Pra, për ekzistimin e kësaj vepre penale, kusht i domosdoshëm është realizimi arbitrar i ndonjë të drejte të tij apo ndonjë të drejte të supozuar dhe në këtë rast nuk është me rëndësi nëse me të është rrezikuar ose jo e drejta e dikujt.

B. Vendimi në lidhje me fajësinë;

Me qëllim të vërtetimit të pretendimeve të aktakuzës gjykata e zhvilloj seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën seancë u administruan provat e propozuara nga prokuroria dhe mbrojtësi i te pandehurit, përkatësisht u dëgjuan në cilësi të dëshmitarëve I. A. dhe A. H. si dhe janë administruar provat materiale të propozuara nga prokurori si Deklarata e të dëmtuarit I. A. e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt. 14.03.2022, Deklarata e të pandehurit V. A. e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt. 14.03.2022, Foto Albumi i vendit të ngjarjes, Raporti i oficerit Sh. S. me nr. të rastit 2022-...-..., e po ashtu edhe provat e propozuara nga i dëmtuari, përkatësisht u administruan provat materiale Leja e punës për DPSH-A. e dt. 04.02.2005, Procesverbali i lëshuar nga Inspektorati i Tregut me dt. 06.01.2005, Faturë e lëshuar nga Agjensia Kosovare e Privatizimit për pagesën e qirasë në emër të I. A. , Procesverbali nga H. D. i dt. 23.06.2006.

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit I. A. , në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 22.07.204, në pyetjet e prokurorit deklaroi se “Kioska e cila gjendet në Raushiq Pejë, është e imja, e kam nga viti 2003, kioskën e kam shfrytëzuar vetë si autolarje ndërsa brenda e kam pasur edhe një berber prej Isniqi i cili kur nuk ka pasur punë më ka ndihmuar në auto-larje. Me dt. 14.03.2022, ka qenë viti i katërt që ia kam lëshuar me qira A., i cili e ka pas vetëm sezonale se vetëm lula ka shitë, e ka marrë nga 1 marsi e deri në tetor, unë kam qenë në shtëpi atë ditë kur A. më ka telefonuar dhe më ka thënë se e ka gjet mbyll kioskën, lulat i ka pasur brenda kur ka shkua i ka gjetur drynat e dikund për 48 orë apo 52 orë lulat i kanë mbetur të mbyllura, e kemi lutë me A., V. me e hap kioskën që mos t’i dëmtohen lulat, por ky nuk e ka hap, ai më ka kërkuar zgjidhje se më ka thonë “Isë me ty kam fol dhe du zgjidhje” dhe jemi detyruar me lajmërua rastin ne polici. A. më ka lajmëruar menjëherë se kioska është e mbyllur dhe kam shkua aty e kemi fotografuar edhe unë edhe ai, bile edhe policia kur ka ardh. Unë kam bërë marrëveshje me A. për qiranë e kioskës sepse ka qenë e imja, kemi pas vetëm marrëveshje gojore. Kioska akoma është e mbyllur me drynat që ia ka vendos V..

Gjykata e vlerësoj dëshminë e te dëmtuarit ne cilësi te dëshmitarit dhe te njëjtës ja fali ne tërësi besimi, pasi qe dëshmia e tij është ne përputhje edhe me dëshminë e dëshmitarit A. H. dhe vete mbrojtjen e te pandehurit sa i përket fakteve relevante, sepse i dëmtuari dhe i pandehuri kane

dallime ne lidhje me pronësinë e kioskës dhe me faktin se a ja kanë shitur apo jo kioskën këtu dëshmitarit A., mirëpo sa i perfekt faktit kryesor qe është vendosja e dryrëve nga i pandehuri, te gjithë përfshirë edhe te pandehurin e konfirmojnë te njëjtin fakt.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.13.11.2024, u dëgjua dëshmitari i propozuar nga mbrojtësi i të pandehurit, av. Blerim Ademaj, A. H.i cili në pyetjet e mbrojtësit, deklaroi se “V. A. e njoh përmes vëllait të tij I. A. , ndërkaq I. e njoh prej që kemi qenë në shkollë shumë më herët. Unë merrem me punimin e luleve dhe kam pasur një kioskë me lule në Raushiq, të cilën e kam marr prej I., në të cilën kam qëndruar 2 vjet me qira prej 50 euro në muaj. Në pyetjen e mbrojtësit të të pandehurit av. Blerim Ademaj, se a e din se e kujt është kioska, i njëjti ka deklaruar se “unë kam pasur punë me I. dhe nuk kam ditë më shumë se e kujt është ajo kioskë, me të pandehurin kam biseduar më vonë diku në vitin e dytë, kur i njëjti dhe më ka thënë që ai e ka blerë kioskën. I pandehuri më ka thënë se dëshiron më shit edhe veç muhabet ka qenë, nuk kemi bërë pazar, nuk i kam jep para as kurrgjë. Qiranë ia kam paguar I. A. . Për shitblerje të kioskës kam bërë vetëm muhabet me V. A. sepse kioska ka qenë e madhe ndërsa unë kam blerë një kioskë më të vogël. Kioskën e kam lëshuar në vitin e tretë, unë kam qenë në Gjakovë në pazar, kur jam kthyer V. ia kishte vendosur drynat vetë, pastaj unë i kam tërheqë lulet e mija sepse nuk më ka mbet vend për të qëndruar aty. V. i ka hapur dyert dhe unë kam tërheq materialin tim. Ndërsa për mbylljen e kioskës, dëshmitari deklaroi se e ka njoftuar i pandehuri dhe i ka thënë se “e kam mbyllur dugojen me dry”, pastaj ka biseduar me të dëmtuarin I. A. , i cili i kishte thënë se merrem unë me të.

Dëshmitari tutje në pyetjet e të pandehurit ka deklaruar se “V. më ka treguar se kjo pronë ka dal e një serbi dhe duhet me largu kioskën sepse i njëjti dëshiron me na paditë, pasi që ia ka vendosur drynat. Të nesërmen kam biseduar me të dëmtuarin dhe i kam treguar për bisedën me të pandehurin lidhur me shitblerjen e kësaj kioske për shumën rreth 1,000 euro dhe I. më ka thënë se për këtë shumë e blej unë këtë kioskë. Nuk është e vërtetë që unë kam thënë që kioskën dua ta dërgoj në L.”.

Në pyetjet e prokurores së shtetit i njëjti deklaroi se “Kioskën e kam marrë nga I. , me të cilin kemi pasur veç marrëveshje gojore. Të njëjtën e kam mbajtur me qira rreth 2 vite e një muaj apo dy, por ka qenë vetëm sezonale. Kur V. më ka thënë se e ka blerë kioskën nuk më ka prezentuar asnjë dokument. Pas mbylljes së kioskës nga V. , i njëjti më ka thirrë në telefon dhe më ka thënë pse e keni kthyer në anën tjetër kahjen pa më pytur mua, unë i kam thënë se kam fol me I. dhe

I. më ka thënë se unë e marr mbi vete, I. është përgjegjës. Në pyetjen e prokurores se gjatë bisedës në telefon i pandehuri a i ka thënë se “mo në atë kioskë nuk du me të pa”, dëshmitari deklaroi se “po ashtu më ka thënë”. Kur V. i ka vendosur drynin kioskës nuk më ka thënë se ka fol me I. dhe nuk e di arsyen pse i ka vendosur drynin asaj kioske.

Në pyetjen e të dëmtuarit, dëshmitari deklaroi se “Unë e kam ditë se kioska është e I., për atë arsye edhe e kam marrë sepse po ta dija e kujt është nuk e kisha marrë. Kam qenë në dijeni se në atë kioskë I. ka vepruar si auto-larje sepse aty te I. kam larë veturën time. Më kujtohet kur kemi bërë marrëveshje gojore për qira të asaj kioske dhe jemi marrë vesh që qiraja të jetë 50 euro, ndërsa për vitin e tretë qiraja do të ishte 70 euro. Në bazë të bisedës e di që I. ka pasur leje për autolarje, mirëpo unë nuk e kam par se a ka pasur leje apo jo. Për blerjen e kësaj kioske unë kam biseduar edhe me I. por edhe me V., I. më ka thënë se kioska është e tij, ndërkaq V. me thoshte se e ka blerë kioskën. Kur kam kërkuar ta blejë kioskën nga I. , më ka thënë se nuk është në shitje dhe pastaj V. më tha se “kioska është e imja” dhe të njëjtit i kam thënë se nuk blejë kioskë nga ti pa u marr vesh me I. . Është e vërtetë se i pandehuri ditën e parë nuk mi ka liruar lulet dhe i ka vendosur dry shtesë, atë ditë nuk ma ka hap kioskën por të nesërmen e ka hap. Kur kam shkuar të nesërmen kam parë që i kish vendosur dy dryna dhe shtesë di. më të mëdhenjë dhe e kishte shkru në një letër se “trafika është e imja”. Është e vërtetë se të dëmtuarit i kam thënë të nesërmen del shiko se duhet me i heqë lulet sepse po më shkojnë dom dhe i kam mbi 1,000 euro lule dhe ti je përgjegjës. Ndërsa i njëjti më ka thënë se për me zgjidhë problemin duhet me thirrë policinë”

Në pyetjet e Gjykatës, dëshmitari deklaroi se “Në kohën kur kam marrë kioskën me qira nga I. nuk e kam njohur V., hera parë që e kam takuar V. ka qenë në vitin e dytë kur ka ardh, ka blerë lule dhe më ka treguar se është vëllau i Is.. Nuk më ka thënë asgjë lidhur me pronësinë e kësaj kioske në këtë takim, në herën e dytë apo të tretë më ka thënë se këtë kioskë e kam ble unë dhe është e imja. Në fillim nuk më ka thënë të largohem nga kioska dhe asnjëherë nuk ka kërkuar largimin tim përder I. kam pa që ka vendosur dry aty në vitin e tretë. Drynat janë vendosur nga V. pa paralajmërim”.

Gjykata e vlerësoj dëshminë e këtij dëshmitari dhe gjeti se e njëjta është bindëse, kjo dëshmi përputhet edhe me dëshminë e të dëmtuarit I. A. pasi qe faktet e njëjta qe të dy i përshkruajnë në mënyrë të njëjtë e qe ka te beje me rastin konkret, andaj gjykata ja fali besimin e plotë kësaj dëshmie dhe përmes saj vërtetohet se ne kioskën në fjalë, i pandehuri V. A. , pa paralajmërim

kishte vendosur drynat, duke i pamundësuar këtu dëshmitarit të ketë qasje ne hapësirën të cilën deri ne atë moment e kishte me qera.

I pandehuri V. A. në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor në pyetjet e mbrojtësit të tij av.Blerim Ademaj deklaroi se “Për kioskën që po bëhet fjalë, e kemi porositë në Fushë Kosovë, në vitin 2001 apo 2003, s’jam i sigurtë për datë, pas dy jave kemi shkuar bashke me dhëndrin I. B. për ta marrë dhe e kemi vendosur në atë pronë duke menduar se është e jona, duke qenë se në atë kohë kisha raporte të mira me vëllaun ia kam lëshuar për shfrytëzim. Pesë vite kanë shkuar ashtu dhe është mbyllur, 10 vite apo më shumë ka qenë e mbyllur dhe siç deklaroi edhe më herët ky, I. ia ka lëshuar A. me qira për sezonë sa muj e di për dy vite dhe ajo pronë dul se është e një serbi me gjeodet duke mat diçka dhe më ka thënë serbi se “dy javë ditë po të jepi afat me e largu kioskën nga këtu se është pronë e imja, kam dhe fletën poseduese përndryshe do të ngriti padi për uzurpim prone”, në atë kohë A. e kishte me qira dhe i thash a je i interesuar me e ble se duhet me e largu prej këtu, i thash 1,000 euro, dhe ai e kish pas thirrë I. dhe i kish pas thonë “ e kam blerë trafiken prej V. 1,000 euro dhe du me e qu në L., dhe ky i kish pas thonë se për 1,000 euro e ndali unë. A. tha se “unë nuk po e blej pasi që ju paskeni konflikt dhe qato lule vij dhe i hekë nga aty nesër” të nesërmen më ka thirrë, kam shku ja kam hap derën dhe i ka hekë lulet. Çelësat e drynave kanë qenë tre palë dhe një palë kanë qenë tek unë, një palë në R. dhe një palë tek I. . Tash atë pronë e ka blerë një person i J. dhe e ka ndërto një pompë dhe më ka thënë hajde me e hekë kioskën sepse I. i kishte thënë fol me V..

Në pyetjet e Prokurores së shtetit, i njëjti ka deklaruar se “kioskën e kam blerë në Fushë Kosovë e jo në Mitrovicë, Policia e kanë shkruar gabim që e kam blerë në Mitrovicë sepse unë asnjëherë nuk kam qenë në Mitrovicë. Për afatin dy javor për largim të kioskës nuk kam mundur ti tregoj I. pasi i njëjti tash e tre vite na ka qitë nga shtëpia mua dhe katër motrat”.

Në pyetjet e Gjykatës, i pandehuri ka deklaruar se “Kioskën njëherë e ka blerë A. për 1,000 euro dhe tha se e qoj në L. dhe e kish thirrë I. i kishte thënë se qiranë më nuk ta paguaj sepse kioskën e bleva për 1,000 euro nga V. dhe po e dërgoj në L.. Meqenëse kam biseduar me A. për shitblerjen e kioskës dhe si përfundim nuk ka dashtë ta blejë, i kam kërkuar të njëjtit ta lirojë kioskën pas vendosjes se drynave. I. nuk i kam kërkuar diçka të tillë pasi që ne nuk flasim mes vete, deri në momentin e vendosjes se drynave kioskën ne shfrytëzim e ka pasur A. H., mirëpo unë nuk kam bërë asnjë marrëveshje që t’ia lëshojë më qira, I. ia ka lëshuar të njëjtit dhe unë nuk kam qenë në dijeni se kur ia ka lëshuar me qira, vetëm për sezone. Në fillim kam qenë i

pajtimin, ndërkaq është e vërtetë se me dt. 14.03.2022 kam vendosur dry të ri dhe nuk i kam lënë mundësi A. H. që të hyjë në kioskë”.

Gjykata e analizoj me vëmendje mbrojtjen e të pandehurit dhe rezulton se e njëjta nuk gjënë mbështetje në asnjërin nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, për me tepër të gjitha provat duke përfshirë edhe dëshmitarët vërtetojnë të kundërtën e pretendimeve të të pandehurit, andaj gjykata nuk ja fali besimin mbrojtjes së tij pasi që e njëjta ka për qëllim që të shmang përgjegjësinë penale për veprën e kryer. Është interesant fakti se i pandehuri në mbrojtjen e tij bije në kundërshtim edhe me vete dëshminë e dëshmitarit të propozuar nga mbrojtja, tutje vërehet se i pandehuri jep deklaratë të cilat nuk përputhen me ato të dëshmitarit A., bile janë kontradiktore edhe me vete mbrojtjen e të pandehurit, pasi që njëherë thotë se është pajtuar që I. ta lëshoj kioskën me qera, pastaj thotë se nuk e kam ditur se e ka lëshuar, pastaj thotë se këtë kioskë e ka blerë A. H., pastaj thotë se nuk e ka blerë për shkak të problemeve pronësore, mirëpo si përfundim i pandehuri në mbrojtjen e tij nuk e mohon faktin se ja ka vendosur drynat këtu dëshmitarit me çka ja ka pamundësuar qasjen në kioskë të cilën e ka pasur me qera deri në atë moment.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare mbeti në tërësi pranë aktakuzës dhe pretendimeve të shprehura më të, duke shprehur bindjen se me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor është arritur që të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri V. A., me dt. 14.03.2022, rreth orës 12:06 minuta, në fsh. R., Komuna e Pejës me dashje ushtron në mënyrë arbitrare të drejtën që mendon se i takon në vend që ti drejtohet organeve kompetente, kështu ka kryer veprën penale “Vetëgjyqësia” nga neni 410 par. 1 të të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, si dhe me rastin e shqiptimit të dënimit si rrethanë lehtësuese të mos merret asnjë fakt, ndërsa si rrethanë rënduese të merret e kaluara kriminale e të njëjtit.

I dëmtuari I. A. në fjalën përfundimtare deklaroi se “Unë ja lë Gjykatës në vlerësim”.

Mbrojtësi i të pandehurit, av. Blerim Ademaj, në fjalën përfundimtare deklaroi se “Gjatë këtij shqyrtimi u vërtetua se i akuzuari nuk është kryerës i veprës penale me të cilën ngarkohet, pasi që sipas aktakuzës nuk kanë arritur ta argumentojnë se pala e dëmtuar se çka është dëmtuar. Po ashtu gjatë këtij shqyrtimi me dëgjimin e dëshmitarit A. Hu., u vërtetua se i akuzuari ka pasur negociata për shitblerjen e kioskës. Po ashtu dëshmitari e pranoi se janë marrë vesh për shitblerje

të kioskës, mirëpo pasi që i njëjti ka biseduar me vëllaun e tij I. , i njëjti ka thënë se “për këtë çmim do e blej vetë”. Kjo deklaratë e dëshmitarit ka përputhje të plotë me mbrojtjen që e dha sot i akuzuari V. A.. Ndërsa, sa i përket provave të propozuara sot nga i dëmtuari, ato prova nuk argumentojnë asgjë, pasi që veprimtaria e biznesit auto-larje, është zhvilluar jashtë kioskës, ndërsa sipas dëshmitarit në kioskë ka qenë një sallon ondulomi dhe i propozoj Gjykatës që ndaj të mbrojturit tim të mirret aktgjykim lirues.

I pandehuri V. A. në fjalën përfundimtare deklaroi se “Sikur të ishte pronë e tij, unë nuk kam pasur nevojë me shku dhe me ja qitë drynin, ose tash qysh po duhet me e largu, dhe unë absolut nuk e ndjej vetën fajtor, e sa i përket Mitrovicës aty policia e kanë shkruar gabimisht”.

Gjykata duke u bazuar ne nenin 7 dhe nenin 8 par.2 të KPPRK-së i vlerësoj provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, duke analizuar me vëmendje fuqinë e tyre provuese, duke vlerësuar secilën provë veç e veç dhe te gjitha së bashku nxori përfundimet si në vijim.

Është vërtetuar pa mëdyshje se i pandehuri V. A. me dt. 14.03.2022 rreth orës 12:06 min, në fshatin R. Pejë, me dashje dhe me vetëdije të plotë ka kryer veprën penale “Vetëgjyqësia” nga neni 410, par.1 të KPRK-së, duke vendosur drynin në mënyrë arbitrare në kioskën e vëllait të tij këtu të dëmtuarit I. A. , duke i pamundësuar qiraxhiut A. H. qe ta shfrytëzoj kioskën, e një gjë të tillë është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit A. H.dhe po ashtu edhe më vetë mbrojtjen e të pandehurit V. A..

Është vërtetuar fakti se përdor I. kioska ishte në shfrytëzim të qiramarrësit të asaj kohe, këtu dëshmitarit A. H., i pandehuri e ka telefonuar qiramarrësin A.H. duke iu drejtuar me fjalët “mo në atë kioskë nuk du me të pa” e më pas në mënyrë arbitrare ka vendosur dry duke ia pamundësuar hyrjen e të njëjtit në kioskë.

Gjykata e mori parasysh edhe pretendimin e të pandehurit dhe mbrojtësit, se kioska është pronë e tij, mirëpo në këtë rast nuk ka fare relevancë çështja e pronësisë, relevant është fakti nëse i pandehuri e ka ndërmarr veprimin qe ne mënyrë arbitrare ta realizoj të drejtën e tij për vendosjen e posedimit në kioskën kontestose, e këtë fakt e vërteton vete i pandehuri në mbrojtjen e tij ku e konfirmon se pa paralajmërim dhe ne mënyrë arbitrare e ka marr kontrollin-posedimin e kësaj kioske.

Nga gjendja e fakteve të vërtetuara si dhe me provat e administruara personale dhe materiale-formale, gjatë këtij shqyrtimit kryesor, gjykata ka ardhur në përfundim se i pandehuri V. A. me veprimet e tij është inkriminuar në figurën e veprës penale “ Vetëgjyqësia” nga neni 410 par.1 të KPRK-së të përshkruar si në dispozitivin të këtij aktgjykimi.

Vendimi në lidhje me dënimin;

Gjykata kur vendosi në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit të përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në nenet 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074), dhe atë duke pasur parasysh qëllimin e dënimit, rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese të nxjerra nga faktet e çështjes dhe duke aplikuar udhëzuesin për politikë ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës, si në vijim.

Kur vendosi në lidhje me dënimin kryesor gjykata u mbështet në nenin 40 par.1 pika 1.3 si dispozita të përgjithshme dhe dispozitën e veçantë nga neni 410 par.1 nën të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) që e përcakton veprën penale “Vetëgjyqësia” dhe dënimin për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri.

Neni 410 par.1 i KPRK-së, përveç që përcakton veprën penale e përcakton edhe minimumin dhe maksimumin e dënimit, që është dënim me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj , ku pastaj gjykata duke u mbështetur në rrethanat e rastit konkret bëri individualizimin e dënimit për të pandehurin V. A..

Pas analizimit të provave të bashkëngjitura lëndës dhe deklarimeve të palëve, gjykata si rrethanë renduese për të pandehurin V. A. gjeti shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale ndaj të dëmtuarit I. A. , ndërsa rrethana lehtësuese nuk gjeti.

Shkalla e lartë e dashjes nga ana e të dënuarit shprehet përmes insistimit të tij për të kryer veprën penale ndaj të dëmtuarit I. A. , ku i njëjti pasi që fillimisht ka telefonuar qiramarrësin A. H. duke iu drejtuar me fjalët “mo nuk du me të pa në kioskë” pastaj, në mënyrë arbitrare kishte vendosur dry në kioskën e vëllaut të tij, duke ia pamundësuar hyrjen e shfrytëzuesit të kioskës në atë kohë, A. H.. Kjo është një veprë penale që kryhet vetëm me dashje direkte, sepse për ta realizuar figurën e sajë fillimisht duhet krijuar ideja se një e drejtë të takon pastaj duhet te planifikosh

ndërmarrjen e veprimit që të realizosh këtë të drejtë nëse është nevoja edhe me dhunë duke shpërfillur realizimin e të drejtës përmes rrugëve ligjore.

Pra, i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm se me veprimet që do ti ndërmerr do shkaktonte një pasojë të ndaluar me ligj, mirëpo i njëjti është pajtuar dhe ka dashur që pasoja të shkaktohet.

Si përfundim gjykata vlerësoj rrethanat renduese dhe lehtësuese secilën veçanërisht dhe te gjitha së bashku, raportin dhe ndikimin e tyre në njëra tjetrën dhe në kontekst të qëllimit të dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe erdhi në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në nenin 69 dhe 70 dhe të Kodit Penal të Republikës së Kosovës .

B. Dënimi me gjobë;

Gjykata në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka vendosur që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënim me gjobë në lartësi prej 1,000 (njëmijë) euro, të cilin dënim detyrohet ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast që i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

Dënimin më gjobë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë shqiptimin e dënimit me gjobë ose me burgim në mënyrë alternative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së vendosi që të pandehurit t'i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer dhe se lartësia e gjobës është proporcionale me nivelin e rrezikut dhe dëmit të shkaktuar me veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale të kryera nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike, u mor në bazë të nenit 462 par.1 të KPPRK-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarën e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

Andaj, duke u mbështetur në fakte, provat dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.290/22, me datë 25.11.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale:

Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.